



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.02.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 12 dhe 19 shkurt 2019.
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 4 deri më 22 mars 2019
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Damian Gjijnuri, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Elena Xhina, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Tom Doshi

Të ftuar:

Thimjo Plaku – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Alba Canaj – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pina – specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Aurora Alimadhi – përfaqësuese e Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Greta Gjoncaj – përfaqësuese e Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Besfort Lamallari – Zëvendësministër i Punëve të Brendshme

Dalimir Kurti – specialist në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Orest Afezolli – përfaqësues nga Instituti i Policisë Shkencore (daktiloskopia)

Ela Zaimi – përfaqësues nga Instituti i Policisë Shkencore (ekzaminimet biologjike)

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kourumi është bërë për të vazhduar mbledhjen. Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 12 dhe 19 shkurt të vitit 2019. A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohen procesverbalet e mbledhjeve 12 dhe 19 shkurt të vitit 2019.

Si pikë e dytë në rendin e ditës kemi miratimin e kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 4 deri më 22 mars të vitit 2019. Kalendarin e keni mbi tavolinë. A ka sugjerime për kalendarin? Nuk ka.

Miratohet kalendari i punimeve të Komisionit të Ligjeve për periudhën 4 deri më 22 mars të vitit 2019.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës që është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”. Komisioni i Ligjeve në shqyrtimin e këtij projektligji është komision për dhënie mendimi.

Nga Ministria e Brendshme, kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Besfort Lamallari, zëvendësministër, zoti Dalimir Kurti, specialist në Ministrinë e Brendshme, Orest Afezulli nga Instituti Policisë Shkencore dhe zonja Ela Zimi nga Instituti Policisë Shkencore.

Zoti Lamallari, mirë se keni ardhur në komision!

Ju lutem, na bëni një prezantim të kësaj marrëveshjeje për kolegët e mi të komisionit dhe më pas fjalën e ka relatori.

Besfort Lamallari – Përshëndetje i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më 13 shtator të vitit 2018 në Vjenë u nënshkrua marrëveshja ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, si dhe marrëveshja e saj zbatuese.

Palët e Konventës janë gjithsej 11 vende, 5 vende të BE-së dhe 6 vende të Ballkanit Perëndimor, të cilat me anë të këtij projektligji synojnë forcimin e bashkëpunimit policor ndërkufitar, veçanërisht në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm.

Kjo marrëveshje përmban rregullat për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve. Çfarë përfiton Shqipëria nëpërmjet kësaj marrëveshjeje? Është e qartë që, falë implementimit të kësaj marrëveshjeje, krijohet mundësia që Shqipëria të shfrytëzojë 10 *database*-t e vendeve të ndryshme, nënshkruese të kësaj konvente, për kërkimin e menjëhershëm automatik online në gjurmë gishtash, profile ADN-je dhe të dhëna automjeteve të ruajtura në bazat e të dhënave të 5 vendeve të BE-së dhe të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo bëhet e gjitha në funksion të një lufte më efektive kundër krimit të organizuar, krimit ndërkufitar, hetimit të krimit, parandalimit dhe vënies para përgjegjësisë së autorëve të tyre, që do të thotë, pavarësisht nëse janë shtetas shqiptarë, që kanë kryer krime këtu dhe jashtë vendit apo anasjelltas, e më tej, edhe nëse këta shtetas kanë ndërruar identitetet, të dhënat biometrike nuk mund të ndryshohen, por janë të ruajtura në bazën e të dhënave të këtyre vendeve nënshkruese dhe rrjedhimisht Shqipërisë i krijohet mundësia për të pasur një bazë më të gjerë të dhënash për hetimin dhe zbulimin e autorëve.

Megjithëse kjo marrëveshje nuk është një përafrim i drejtpërdrejt i legjislacionit të *acquis communautaire*, por, në fakt, i jep një hov shumë të madh Shqipërisë në çështjet e progresit, në kapitullin 24, pasi kjo marrëveshje është replikim i marrëveshjes së Prum-it, e cila është zbatuar me sukses në nivel evropian për shkëmbimin automatik të të dhënave.

Kjo marrëveshje ka të gjitha garancitë e nevojshme për ruajtjen e konfidencialitetit, sepse të dhënat personale të shtetasve do të mbrohen. Siç e thashë edhe më parë, kjo marrëveshje është aplikuar me sukses dhe vazhdon të aplikohet me sukses në vendet anëtare të BE-së dhe, përveçse tregon një vullnet të qartë, solid në luftën kundër krimit të organizuar dhe në përmbushje të pritshmëri, së pari, të qytetarëve shqiptarë, por edhe detyrave karshi integritetit evropian, në fund të fundit, është edhe në përputhje me programin e qeverisë shqiptare, të parashikuar për shtetin e së drejtës dhe demokratizimin e shoqërisë, krimin e organizuar, terrorizmin dhe trafikimin.

Kjo marrëveshje është shumë e mirë, që për fatin e mirë të Shqipërisë ka gjetur mbështetjen politike dhe mundësitë për financim, pasi krahas marrëveshjes, në shtator të vitit të kaluar u nënshkrua, gjithashtu, edhe një memorandum bashkëpunimi mirëkuptimi në mes ministrave nënshkrues, të cilët përmes këtij memorandumi synonin gjetjen e financimeve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Austria ka marrë përsipër të jetë mentore për Shqipërinë në aspektin politik në raport me Komisionin Evropian, por edhe për ofrim të ekspertizës në funksion të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Lamallari.

Fjalën e ka zoti Shameti si relator.

Adnor Shameti – Faleminderit!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme sqaruan në detaje objektin, qëllimin dhe përmbajtjen e këtij projektligji, me anë të të cilit synohet forcimi i bashkëpunimit policor ndërkufitar ndërmjet vendeve të Europës Juglindore në luftën kundër terrorizmit, krimin ndërkufitar dhe emigracionit të paligjshëm, duke luftuar kërcënimet e sigurisë publike për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale. Marrëveshja që ratifikohet përmban rregulla për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, të të dhënave daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve. Me anën e shkëmbimit automatik të të dhënave të ADN-së dhe daktiloskopike Shqipërisë i krijohet mundësia që të shfrytëzojë bazat e të dhënave të shteteve tjera që do të bëhen palë në marrëveshje duke i dhënë akses që të kontrollojë profilet e ADN-së, shenjat daktiloskopike dhe të dhënat e regjistrimit të automjeteve si të shtetasve shqiptarë ashtu edhe profile të ADN-së të ngjarjeve kriminale të ndodhura në Shqipëri, me qëllim identifikimin *online* të personave që janë përfshirë në këtë aktivitet kriminal ose kanë ndryshuar të dhënat e tyre identifikuese si emër dhe mbiemër.

Së fundi, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Si relator, vlerësoj mundësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë!

Ulsi Manja- Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia- Faleminderit!

Kjo marrëveshje ka të bëjë me rritjen e sigurisë kombëtare dhe është një gjë shumë E mirë e nënshkruar nga ministrat në shtator të vitit të kaluar, por, duke parë shtetet pjesëmarrëse të cilat i përkasin Europës Juglindore, do të isha i interesuar të dija që shtete siç janë: Bosnja, Bullgaria, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Mali i Zi, a e kanë nënshkruar në parlamentet e tyre, apo jemi shteti i parë që po e nënshkruajmë?

Besfor Lamallari - Për momentin, sipas informacionit të përcjellë nga Sekretariati i Përgjithshëm i Konventës, Sllovenia nuk arriti ta nënshkruante, sepse pati një rrëzim qeverie, ndërsa Bosnja nuk e ka nënshkruar për shkak të mungesës teknike, pra nuk ka një database unike. Austria e ka, sepse është në kuadër të marrëveshjes së Prymit, e cila, në fakt, është replikimi i kësaj marrëveshjeje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Urime për marrëveshjen dhe relacionin, që është shumë cilësor dhe i detajuar.

Unë kam një pyetje lidhur me ngritjen e sistemit ose të rrjetit të kriptuar TESTA, që do të bëjë të mundur realizimin e kësaj lidhjeje. Ju thoni që koha dhe kostot varen nga institucionet, por a keni ndonjë kalendar ose plan kur mendohet që ky sistem dhe kjo marrëveshje sigurisht që do të bëhet efektive.

Faleminderit!

Besfort Lamallari - Faleminderit për pyetjen, zonja deputete!

Ky është një proces shumë i rëndësishëm, pasi implementimi i marrëveshjes varet nga ky kanal komunikimi, që është sistemi i inkriptuar TESTA i Komisionit Europian. Përtej marrëveshjes, për shkëmbimin e inkriptuar të sigurt të të dhënave që parashikon marrëveshja përmes sistemit TESTA, parashikohet shkëmbimi i sigurt i të dhënave të fushave të ndryshme të drejtësisë, të financave, në dogana, tatime e të tjera.

Ministria e Brendshme ka nisur një proces pune bashkë me AKSHI-n, që në momentin e negociimit të marrëveshjes i parapriu punës për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e personave dhe subjekteve, të cilët do të ishin të përfshirë ose dhe me interes për shfrytëzimin e sistemit TESTA për të identifikuar gjithashtu edhe sistemet që mund të zëvendësohen, sepse sot Shqipëria përdor disa sisteme, por përmes aplikimit të sistemit TESTA këto mund të zëvendësohen dhe të ketë kanal komunikimi me EUROPOL-in, me Komisionin Europian dhe agjencitë homologe të vendeve të tjera.

Në komunikimin me Komisionin Europian, përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme kanë negociuar edhe çështje të termave financiarë të kalendarit të nevojshëm të implementimit të këtij sistemi, por edhe të mundësive të financimit. Aktualisht, Komisioni Europian ofron disa mundësi financimi, siç është programi IZA2, vendet e Ballkanit Perëndimor e kanë aplikuar këtë, edhe ne po shikojmë mundësinë e aplikimit të këtij programi, megjithatë duhet të ketë dakordësi të të gjitha institucioneve se cilët janë të interesuarit të kenë akses të drejtpërdrejtë në këtë kanal komunikimi të sigurt të Komisionit Europian.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Zoti Hyseni ka një pyetje.

Alket Hyseni – Faleminderit, kryetar!

Zoti zëvendësministër, është kënaqësi që ju kemi sot këtu!

Në këtë marrëveshje konstatoj se palë është edhe mbretëria e Holandës.

(Diskutim pa mikrofon)

...mes Republikës së Belgjikës, Gjermanisë, Spanjës, Francës, Luksemburgut, Holandës. Për çfarë është kjo? Është për nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar dhe në ndihmë të kësaj vjen edhe kjo marrëveshje, apo jo?

Besfort Lamallari – Së pari, kënaqësia është imja që ndodhem këtu!

Referenca që ju bëni, në fakt, marrëveshja e primit është dokumenti bazë, e cila zbatohet në nivel të Bashkimit European.

Alket Hyseni – Pyetja ka të bëjë me faktin se çfarë roli ka Ministria e Brendshme me këto shtete që lidhim marrëveshje dhe a përfiton Republika e Shqipërisë nga kjo marrëveshje?

Duke marrë shkas nga fakti që në datën 24 ishte përvjetori i vrasjes së kryekomisarit Dritan Lamaj, një nga shtetet perëndimore, me të cilin kemi lidhur shumë marrëveshje dhe që na bën shpesh kritikun, nuk e ka ekstraduar personin që është dënuar për vrasjen e këtij kryekomisari. Çfarë roli ka ministria në skuadër të marrëveshjeve që kemi, në kuadër edhe të Bashkimit European apo edhe bilateral për realizimin e ekstradimit të shtetasve, të cilët janë dënuar nga gjykatat shqiptare me vendim të formës së prerë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Lamallari.

Besfort Lamallari – Kjo marrëveshje lidhet me çështjen e hetimit për sa i përket policisë, gjë që prek edhe Ministrinë e Brendshme. Ekstradimi, sipas Kushtetutës, Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale është prerogativ dhe detyrim përgjegjësie e Ministrisë së Drejtësisë dhe e organeve gjyqësore, përfshi edhe Prokurorinë. Në këtë aspekt, sa i përket edhe informacionit të shkëmbyer në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare Ministria e Brendshme përmes shtyrjes përpara dhe nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve tregon gjithë vullnetin e saj për të partnere serioze në krah të vendeve europiane.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të kësaj marrëveshjeje.

Kush është dakord në parim me marrëveshjen? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të kësaj marrëveshjeje.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë në votimin në tërësi të marrëveshjes. Kush është dakord në tërësi me marrëveshjen? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi marrëveshja.

Projektligji së bashku me raportin përkatës do t'i përcillen komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Këtu mbyllet pika e tretë e rendit të ditës.

Faleminderit zoti Lamallari dhe stafit që ju shoqëron!

Ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.02.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Damian Gjijknuri, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Elena Xhina, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho deh Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Tom Doshi

Të ftuar:

Thimjo Plaku - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Alba Canaj - Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pina – Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Aurora Alimadhi – përfaqësuese e Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Greta Gjoncaj – përfaqësuese e Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”. Në shqyrtimin e kësaj marrëveshjeje komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zoti Thimio Plaku, Drejtor i Përgjithshëm dhe stafi i ministrisë që e shoqëron.

Ndodhet zoti Plaku në komision?

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë 5 minuta pushim dhe do të rinisim mbledhjen.

(Pas pushimit)

Ulsi Manja – Të hyjnë mediet!

Rifillojmë mbledhjen.

Kemi pikën e katërt dhe të fundit në rendin e ditës, që është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese, të marrëveshjes “Për bashkëpunim teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë ratifikuar me ligjin nr.66 të vitit 2017.

E thashë pak më parë se komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Relatori i këtij projektligji do të jetë kolegu Leka.

Nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kemi sot në komision zotin Thimio Plaku, drejtor i përgjithshëm dhe stafin e kësaj ministrie.

Zoti Plaku, do t’ju lutesha shkurtimisht për kolegët e mi të komisionit, por edhe për opinionin publik të na bënit një prezantim të shkurtër të kësaj projekt marrëveshjeje.

Thimio Plaku – Ky ndryshim i marrëveshjes është në vijim të një marrëveshjeje me qeverisë zvicerane, ku autoriteti kompetent ka qenë Ministria e Zhvillimit Urban dhe Territorit.

Siç e dini, kjo ministri nuk ekziston më dhe një pjesë e saj, një pjesë e strukturave të saj, që mbulojnë territorin dhe planifikimin kanë kaluar në ministrinë tonë.

Për këtë arsye, për shkak të ndryshimeve të ndodhura janë dy ndryshimet thelbësore që kryhen, njëri është që kompetencat dhe autoriteti, meqenëse nuk është Ministria e Zhvillimit Urban dhe Territorit, i kalojnë nga pikëpamja politike zëvendëskryeministrit, ndërsa nga pikëpamja e menaxhimit të granteve të projekteve Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Ndërsa pika tjetër është zgjatja e afatit. Kuptohet se për shkak të këtyre ndryshimeve është e nevojshme edhe zgjatja e afatit të zbatimit të këtij programi, kështu që pika e dytë është pikërisht zgjatja e këtij afati.

Nuk kemi asnjë problem apo shqetësim, kështu që gjithë ky ndryshim apo ratifikim i këtij ndryshimi të marrëveshjes përmblihet në këto dy autoritete bashkëpunuese dhe zgjatja e afatit të programit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Plaku!

Urdhëroni, zoti Leka!

Edmond Leka - Faleminderit!

Projektligji vjen si nevojë e amendimit të tekstit të marrëveshjes së bashkëpunimit teknik për programin e zhvillimit rajonal. Ky projektligj synon përcaktimin e autoritetit bashkëpunues të programit, meqë marrëveshja aktuale është e lidhur me Ministrinë e Zhvillimit Urban si agjenci bashkëpunëtoare e projektit. Në këtë aspekt marrëveshja ndryshuese parashikon që drejtimi i projektit të kryhet nga zëvendëskryeministri për aspektet e lidhura me legjislacionin, politikën kombëtare, për zhvillimin e programit kombëtar dhe zgjatjen e afatit deri më 31 mars të vitit 2019. Zgjatja e këtij afati është propozuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim, si edhe nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Kontributi financiar i bankës zvicerane do të jetë rreth 3 milionë e 445 mijë franga, ndërkohë që pala shqiptare do të përballojë kostot e nevojshme për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar rreth 380 mijë franga zvicerane. Kostot e TVSH-së do të mbulohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Në aspektin ligjor dhe procedural projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Kam 2 pyetje, zoti kryetar, dua të di se cila është ecuria e deritanishme e marrëveshjes për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë? A mjafton shtyrja e këtij afati deri më 31 mars të vitit 2019? Ne jemi në fundin e muajin shkurt, a mos kemi nevojë përsëri për shtyrje të kësaj marrëveshjeje?

Ulsi Manja - Po, zoti Plaku, një përgjigje për kolegun.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Plaku, ju lutem ndizni mikrofonin!

Thimio Plaku – ...një marrëveshje ka qenë pezulluar për këtë periudhë. Për sa i përket afatit të programit konsiderohet i mjaftueshëm nga propozuesit.

Ulsi Manja - Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Gjyknuri.

Damian Gjyknuri - Po lexoja relacionin, nisur dhe nga fakti se kam qenë në atë ministri, si arsye përveç afatit si rationale jepet vakumi ligjor i krijuar për shkak të ndryshimit të strukturës së qeverisë. Kam përshtypjen se kjo është totalisht e gabuar. Ne si Komision i Ligjeve duhet të japim opinionin që kjo të hiqet si racional, sepse kompetencat e Ministrisë së Zhvillimit Urban, siç e di edhe zoti Plaku janë thithur nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë dhe ky projekt nuk ka pasur vakum, mund të ketë pasur probleme të tjera, ose qeveria ka mendua t'ia heqë kësaj ministrie dhe t'ia kalojë zëvendëskryeministrit. Pyetja ime është: a është ky qëllimi, i racional, pra që t'ia hiqet Ministrisë së Infrastrukturës dhe t'ia kalojë zëvendëskryeministrit?

E dyta, çfarë roli do të ketë zyra e zëvendëskryeministrit, kur kompetencat dhe funksionet që ka pasur Ministria e Infrastrukturës më parë Ministria e Zhvillimit Urban kanë pasur të bëjnë me aspektet e planifikimit, koordinimit për aspektet e zhvillimit infrastrukturor rajonal? Normalisht, ajo ka qenë ministri që i ka kapacitetet për ta bërë këtë punë. Nëse mendohet se është zgjidhja më e mirë nga ana e qeverisë, përfaqësuesi i ministrisë, zoti Plaku, mund të na i thotë, por nga pikëpamja ligjore, e kam pyetje dhe sugjerim do të insistoj për këtë që të hiqet.

Më mirë të thuhet e vërteta. E para afati. Këtu nuk është ndryshuar vetëm afati, por edhe substanca, pra, është hyrë edhe në thelb.

E dyta, mendohet që t'ia hiqet kësaj ministrie dhe t'ia kalojë zëvendëskryeministrit.

Ulsi Manja – Po, zoti Plaku.

Thimio Plaku – Jam dakord për racionalin, ndërsa për pyetjen tjetër nuk mund të jap përgjigje, sepse janë disa aktorë, këtu për momentin jam vetëm unë, që duhet të përgjigjeshin, Fondi i Zhvillimit.

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit kryetar!

Në fakt, duke e vazhduar atje ku e la kolegu im Gjyknuri, edhe në nenin 1 që do ta votojmë, duhet të bëjmë një korigjim, sepse ne nuk mund të ratifikojmë shtytjen e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, e cila nuk ekziston më si strukturë, dhe Agjencisë Zvicerane të Zhvillimit. Për t'ju qartësuar, në vazhdimësi të asaj që tha zoti Gjyknuri, dua t'ju them se këto kanë qenë projekte të lidhura

me fondet e zhvillimeve të rajonit, që ne i kemi krijuar para disa vjetësh dhe nga pikëpamja e projekteve të huaja i mbulonte ministria, që zoti Gjiknuri e përmendi, dikur Ministria e Zhvillimit Urban dhe Ministria e Infrastrukturës, ndërkohë që vitin e kaluar ka pasur një vendim të qeverisë që të gjitha fondet e zhvillimit rajonal janë shkrirë dhe janë implementuar brenda Fondit të Zhvillimit Shqiptar edhe nga pikëpamja e numrit dhe nga pikëpamja e projekteve zhvillimore që ata kanë pasur. Në rastin konkret çfarë po bëjmë ne sot?! Ky projekt dikur ka qenë pjesë e Agjencisë së Zhvillimit të Rajoneve në bashkëpunim me Agjencinë Zvicerane dhe me ministrinë e linjës. Sot këto elemente nuk ekzistojnë, pra Ministria e Zhvillimit Urban dhe fondi i agjencive të zhvillimit rajonal, por ekzistojnë vetëm Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Ministria e Infrastrukturës. Meqenëse zëvendëskryeministri është kryetar i bordit të FSHZH-së, e drejton politikisht atë dhe meqë të gjitha fondet e rajoneve janë përthithur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit është e detyrueshme... Po ta shikoni me kujdes marrëveshjen, ajo është firmosur nga përfaqësues të qeverisë zvicerane, nga zëvendëskryeministri dhe fare kot nga drejtori, sepse, nëse e firmos zëvendëskryeministri, nuk ka nevojë për firmën e drejtorit, sepse ai është autoriteti më i lartë. Domethënë, situata këtu është thjesht ndryshimi i emërimit të marrëveshjes që ka pasur Ministria e Zhvillimit Urban, që në rastin konkret e ndiqte drejtorja e ministrisë së linjës, nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit me zëvendëskryeministrin. Problemi që duhet të diskutohet në të gjitha këtë marrëveshje është shtyrja e afatit, sepse shtyrja e afatit me 6 muaj nga data 31.09.2018, që duhet të përfundonte, duke e shtyrë deri me 31.03.2019, e ezauron mbylljen e këtij programi, që është firmosur nga qeveria zvicerane dhe ministria e linjës së asaj kohe apo nuk e bën? Domethënë, ajo që ne i japim më shumë rëndësi sesa duhet është shtyrja e këtij programi sesa kalimi që përfaqësuesi i palës sonë do të jetë zëvendëskryeministri apo drejtori ekzekutivi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Pavarësisht se drejtori e tha dhe nuk na ndihmon dot, sepse këtu duhet të ishte drejtori i Fondit Shqiptar të Zhvillimit ose përfaqësues nga zyra e zëvendëskryeministrit për të na dhënë përgjigje përfundimtare që me të vërtetë me 31.03.2019, sipas kësaj firmosjeje që kanë bërë ata, ezaurohet ky program dhe po u ezauroa ne jemi shumë të kënaqur. Ne duhet ta kishim kaluar këtë program që në vitin 2018. Thelbi kryesor i kësaj marrëveshjeje është që ne po shtyjme 6 muaj këtë marrëveshje. Pjesa tjetër, që deri dje ka qenë në varësi të një ministrie dhe sot kalon në varësi të zëvendëskryeministrit nuk ka rëndësi, sepse ai është kryetar i bordit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Siç e dini, ky fond është një aneks, që unë kam folur historikisht për këtë, edhe për kushtet financiare fantastike që kanë ata në raport me ju, kolegë deputetë, është një fushë më vete, është jashtë sistemit të pagave dhe është jashtë sistemit të qeverisë, e cila menaxhon këto fonde. Në rastin konkret, drejtimi politik i këtij fondi

varet nga zëvendëskryeministri, prandaj ne ia kalojmë emrin zëvendëskryeministrit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe u japim të drejtën e plotë atyre. Pyetja ime konkrete është që data 31.03.2019 erdhi, a përfundon kjo marrëveshje? Përpara se ne ta kalojmë dhe nuk jam kundër, si komision, duam të kishim një shpjegim nga Fondi i Shqiptar Zhvillimit apo nga zyra e zëvendëskryeministrit nëse kjo marrëveshje është në rregull që të shkojë në seancë plenare.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Gjikhuri.

Damian Gjikhuri – Dua të bëj një sqarim, meqenëse edhe zoti Fino bëri një shpjegim. Po ta vëmë re, marrëveshja thotë “agjencitë bashkëpunuese”. E para, besoj se nuk ka vakuum ligjor. Ka ndryshim substancial. Nuk ka asgjë të keqe. Jam dakord që për efikasitetin e projektit qeveria ka të drejtë të bëjë çdolloj ndryshimi, ia heq njërit dhe ia jep tjetrit. Kjo është krejt normale dhe nuk diskutohet. Në marrëveshje thuhet “agjencitë bashkëpunuese”, pra Fondi Shqiptar i Zhvillimit Rajonal, që e ka thithur kompetencën Fondi Shqiptar i Zhvillimit, dhe ministria e linjës që ka qenë. Kjo do të thotë se nuk qëndron ajo. Sepse kryetari i bordit ka qenë gjithmonë zëvendëskryeministri. Në qoftë se do të jetë agjencia bashkëpunuese, për të flitet vetëm një herë, jo edhe për kryetarin, edhe për drejtorin ekzekutiv. Kjo do të thotë se kanë qenë dy institucione të ndryshme. Unë e di nga roli që kam pasur si ministër, se nuk është vetëm ky projekt në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Roli i Ministrisë së Infrastrukturës ka qenë planifikues, koordinues dhe në fund marrja përsipër e produkteve. Çfarë ndodh?! Këtu bëhen rrugë dhe nuk i merr njeri në dorëzim. Fondi Shqiptar i Zhvillimit bën rrugë, por nuk i ka marrë njeri në dorëzim, ndërkohë është një institucion i Ministrisë së Infrastrukturës, i cili duhet t’i marrë në dorëzim, ashtu si edhe një pjesë e produkteve të këtij projekti merren në dorëzim nga agjencia bashkëpunuese, e cila në këtë rast ka qenë ministria. Tani i hiqet një ministrie dhe i jepet zëvendëskryeministrit. Nëse mund të jetë mirë apo nëse i ka kompetencat zëvendëskryeministri, nuk e di. Prandaj këto meritojnë sqarim për efekt të së vërtetës dhe nuk ka rëndësi si është e vërteta. Unë them se baza ligjore duhet të ndryshojë dhe t’i themi “hiq këtu, kaloje këtu për efekt të mirë”.

(Reagim pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ta marrim një përgjigje nga ministria.

Bashkim Fino – Para se të flasë ministria, jemi ne.

Ulsi Manja – A i bëtë pyetje atij?! Le të japë përgjigje.

Bashkim Fino – Nuk i bëra fare pyetje. Unë bëra një sqarim diskutimi. Meqenëse kolegu ktheu një përgjigje mbi diskutimin tim, kam të drejtë të kthej një përgjigje. Nuk do të ma japësh fjalën?

Ulsi Manja – Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Për procedurë, e ka kërkuar fjalën Alketi.

Alket Hyseni – Mua më bën përshtypje, zoti kryetar, se zotëria i nderuar është drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës, kurse marrëveshja propozohet nga zëvendëskryeministri, palë janë zëvendëskryeministri dhe ministria, nuk e kuptoj rolin e zotërisë, pa e ofenduar. Ka një të drejtë zotëria pse ka ardhur, sepse logjikisht kjo marrëveshje duhet të ishte tek ajo ministri, por fakti që na e prezanton zëvendëskryeministri, palë është bordi, unë mendoj se nuk ka pse t'i drejtojmë pyetje zotërisë. Zotëria këtu ka ardhur, por normalisht dhe proceduralisht nuk duhet të ishte. Në themel jam me kolegun Gjijknuri: kush do ta zbatojë teknikisht këtë marrëveshje?

Po hyj edhe pak në diskutim, kryetar. A e ka ekspertizën zyra e zëvendëskryeministrit për këtë çështje? Ky është një aspekt tjetër, por le t'ia lëmë komisionit përkatës këtë. Sugjerimet e zotit Gjijknuri ishin me vend dhe unë them që duhet t'i mbështesim.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Në fakt, zoti Plaku është këtu në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Natyrisht, ka edhe përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, pra erdhën zonjat, se ishin te komisioni përgjegjës. Gjithsesi, a ka përgjigje zoti Plaku për pyetjen që bëri kolegu Fino lidhur me zgjatjen e afatit? A është mjaftueshëm afati 13.03.2019, që ju propozoni, se në mars hyjmë nesër?

Thimio Plaku – Mendoj së përgjigjen mund ta japin përfaqësuesit e Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Ulsi Manja – Përfaqësuesja e Fondit Shqiptar të Zhvillimit lidhur me afatin?

Aurora Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne vlerësojmë se afati është i mjaftueshëm, për shkak se procesi ka filluar të ndiqet që në momentin kur marrëveshja ka përfunduar, më shtator të vitit 2018. Në këtë kuptim, edhe zbatuesi i projektit ka konfirmuar që do të përmbillet në mënyrë të suksesshme brenda kësaj periudhe kohore.

Faleminderit!

Ulsi Manja – A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Nëse janë në rregull dhe u del afati 31 mars 2019, kur të vijnë herës tjetër, nuk do t'ua miratojmë zgjatjen e afatit. Kjo punë është e thjeshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse për këta është e mjaftueshme, por erdhën përsëri për zgjatjen e marrëveshjes...

Bashkim Fino – Pse nuk e kanë sjellë më parë? Megjithëse mbaronte më 30 shtator të vitit 2018, çfarë e ka penguar institucionin përkatës që të na i sillte në tetor të vitit 2018 dhe të thoshte: “Ne nuk e realizuam dot afatin dhe kërkojmë edhe 6 muaj kohë”? Do të ishte më me vlerë dhe më efektive t’ia miratonim në tetor të vitit 2018 dhe do të thoshim edhe ne se mbase do ta realizojnë. Por të vish tani, në muajin e fundit, dhe të thuash: “Unë e kam e shtyrë, e kam bërë fakt të kryer, por më voto edhe ti pak në parlament për 6 muaj dhe ta mbaroj më 31 mars”!

Ulsi Manja – Urdhëroni!

Aurora Alimadhi – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, iniciativa për ndryshimin e marrëveshjes bazë ka filluar që në korrik të vitit 2018. Këshilli i Ministrave e ka realizuar miratimin në parim të marrëveshjes në tetor të vitit 2018, për shkak të procedurave.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Zoti kryetar, ne jemi njerëz të përgjegjshëm këtu, dhe nuk dua të akuzoj asnjë njeri, dhe diskutojmë me seriozitet. Unë kur them se procedura ka filluar dhe akti Këshillit të Ministrave ka filluar në korrik të vitit 2018, këtu kam një dokument që ky akt më ka ardhur më 20.02.2019, për mua ky quhet akt. Nuk quhet akt që ka filluar puna në ministri apo në institucione në korrik të vitit 2018, sepse mund ta ketë filluar edhe në korrik të 2013-ës, por për mua si dokument akt është ky 20.02.2019. Më 20.02.2019 ka kaluar në qeveri dhe pas një jave ka ardhur këtu në parlament.

Ju lutem, na ruani integritetin dhe pjesën intelektuale, zoti kryetar! Nuk jeni vetëm për të drejtuar mbledhjen dhe t’i jepni fjalën njërit apo tjetrit. Kjo është e turpshme! Për mua akt është ky. Në qoftë se ju juristët dini ndonjë akt tjetër, ma thoni edhe mua ta mësoj dhe do t’jua them faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino, që ia mbrojtje integritetin komisionit, se fakti është fakt, vendimi e ka datën mbi letër dhe nuk besoj se ka shpjegim tjetër. Mund të ketë nisur që në shtator vitit të kaluar, por vendimi e ka datën sipër. Është fakt që qeveria e ka kaluar më 20 shkurt të 2019-ës. Çfarë përgjigje të të jap?!

A ka diskutime nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Unë vërtet nuk e kuptoj. Unë kuptoj vetëm atë për të cilën folam dhe bëra debat, sepse doja t'i ktheja përgjigje edhe kolegut Gjijnuri. Nuk kishte asnjë diferencë në diskutimin tim me atë të zotit Gjijnuri. Jam plotësisht dakord, sepse, në fund të fundit, mund të shkrihet një ministri, por unë e di se ato që ka pasur Ministria e Zhvillimit Urban i kanë kaluar Ministrisë së Infrastrukturës; ka një drejtori që bën politika e të tjera. Nuk ka asnjë diferencë në atë diskutim. Të vetmen gjë që unë thashë është se kjo çështje i ikën Ministrisë së Infrastrukturës dhe kalon nën drejtimin e zëvendëskryeministrit, që është kryetar bordi, dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Për shkak se fondet e zhvillimit rajonal janë shkrirë dhe nuk janë më me vendim qeverie, mbase ky është një veprim i gabuar që ka bërë qeveria, por kjo është çështje e atyre, sepse e kanë bërë ata. Po të pyesin mua, është i gabuar, sepse nuk mund të forcojmë vetëm një institucion, Fondin Shqiptar të Zhvillimit, ndërkohë që ne i kemi krijuar me qëllim të caktuar Fondet e Zhvillimit të Rajoneve. I kemi krijuar edhe në kuadrin e reformës territoriale që kemi bërë në Shqipëri, në kuadrin e 61 bashkive, në kuadrin e 4 rajoneve të mëdha, për të pasur një integrim dhe për të pasur një bashkëpunim me Bashkimin Europian në mënyrë të vazhdueshme për thithjen e fondeve, jo vetëm nga qeveria, por edhe nga Bashkimi Europian. Kjo ka qenë kryesorja e krijimit të atyre 4 rajoneve të zhvillimit të rajonit. Fakti që këta i kanë shkrirë dhe kanë lënë statukuon e vitit 1993, që kur është krijuar Fondi i Zhvillimit Shqiptar, i cili është krijuar si rezultat vetëm me fondet e donatorëve të huaj, por sot është shpërbërë komplet struktura e Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Sot Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka disa burime të ardhurash dhe burimin kryesor, e kam thënë edhe në buxhetin vitit të kaluar, e ka nga buxheti i shtetit. Kur është krijuar, nuk është krijuar që të ketë burim kryesor buxhetin e shtetit, por është krijuar që burim kryesor të ketë donacione nga të huajt, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor e të tjera, që edhe ata të paguajnë 50%, kostot lokale, që të mos i hyjë anës teknike, se e njoh mirë këtë situatë. Ndërsa në rastin tonë konkret, çfarë ndodh?! Ndodh që ky fond burimin kryesor e ka nga buxheti i shtetit, derisa e ka nga buxheti i shtetit, atëherë ka ndryshuar e gjithë struktura e saj.

Problemi këtu është shumë i thjeshtë. Ky projektligj që ne kalojmë duhet të ndryshohet edhe te neni 1, që të mos bëj diskutim nen për nen, se nuk mund të miratojmë ne përsëri marrëveshje, ratifikim marrëveshjeje, shtyrje, se, në fund të fundit, përsëri shtyrje po bëjmë dhe po themi që politikisht tani e drejton zëvendëskryeministri me fondin, jo më ministria e linjës apo e zhvillimit urban. Por neni 1 këtu është i gabuar, se nuk duhet të shënohet më “Ministria e Zhvillimit Urban”, kur nuk ka më një ministri me emërtim të tillë.

Alket Hyseni – Do t'i shohim kur të vijmë nen për nen.

Bashkim Fino – Këtu duhet të ratifikojmë marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave, përfaqësues nga zëvendëskryeministri, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane. Kaq, se këtu bën shtyrjen e saj.

Në qoftë se këta ikin me idenë e marrëveshjes që kemi kaluar dikur ne, dhe kështu ka qenë, ne sot bëjmë dy ndryshime: edhe politikisht e ndryshojmë, sepse tani kemi zëvendëskryeministrin dhe jo ministrinë e linjës, edhe shtyjmë afatin. Të paktën unë kështu e kuptoj këtë marrëveshje që kalojmë sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të dyja këto gjëra... Ajo është në marrëveshje, por ne duhet të bëjmë korrigjimet e nevojshme, ndaj e diskutova me ju.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

E kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord në parim me marrëveshjen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66 të vitit 2017”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Te neni 1 zoti Fino sugjeron që...

Bashkim Fino – Ndoshta nuk duhet bërë.

Ulsi Manja – ...fjalët “Ministria e Zhvillimit Urban” të zëvendësohen me fjalët “ministrinë përkatëse të infrastrukturës dhe energjetikës”, pasi nuk ekziston më një ministri me këtë emërtim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ndonjë problem? E bëjmë dot me këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aurora Alimadhi – Ndoshta këshilltarët e dinë më mirë, por në vlerësimin tim nuk mund të bësh ndryshim, sepse marrëveshja është nënshkruar tashmë nga palët.

Ulsi Manja – Dakord.

Grua – Komisioni ose mund ta kthejë që palët të rinegociojnë dhe të ndryshojnë tekstin, ose...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Dakord.

Kush është dakord me nenin 1, sipas variantit...?

(Deputeti Hyseni ndërhyr pa mikrofon.)

Po.

Kush është pro nenit 1, sipas variantit që kemi në tekstin e projektligjit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Relatori dhe stafi i komisionit të bëjnë gati raportin dhe t'ia kalojnë komisionit përgjegjës për miratim, si dhe më pas seancës plenare për votim.

Me miratimin e kësaj marrëveshjeje, e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Mbledhja e radhës dhe rendi i ditës do t'u njoftohet kolegëve nga sekretaria e komisionit.

Shumë faleminderit përfaqësuesve të ministrisë dhe të Fondit!

Shumë faleminderit kolegëve për disponibilitetin dhe diskutimin e sotëm!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA